

Sokol Gj /



**SHOQERIA TREGTARE "RIEN" sh.p.k(ne likujdim)
LIKUJDATORI**

Tirane, me 10.05.2009

Lenda: Kerkese per publikimin ne faqen e internetit te Q.K.R-se.

**Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit
Tiranë**

Shoqeria tregtare "RIEN" sh.p.k eshte ne procesin e likujdimit te saj nga data 26.09.2008. Vendimi per prishjen dhe caktimin e likujdatorit eshte depozituar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit me date 29 Shtator 2008 dhe eshte vendosur ne publikimet tuaja "gjendja e rregjistrimit" me status "shoqeri ne likujdim e siper".

Ne baze te nenit 195 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqeritë tregtare", likujdatori i shoqerise duhet te ftojë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Sipas ketij neni, publikimi i fteses behet ".....në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit".

Ne 30.01.2009 ne kemi dorezuar ne sekretarine e QKR-se ftesen e pare per kreditorët dhe po vazhdojme me ftesen e dyte, sipas hapave që kërkon ligji.

Bahkengjitur do te gjeni ftesen e dyte qe ne kemi pergatitur per publikim.

Jemi ne pritje te publikimit ose te nje pergjigjje nga ana juaj.

Duke ju falenderuar

Likujdatori i shoqerise "RIEN" sh.p.k

Hetem SULAJ



**SHOQERIA TREGTARE "RIEN" sh.p.k(ne likujdim)
LIKUJDATORI**

**FTESE PER KREDITORET E SHOQERISE"RIEN" sh.p.k
(Njofimi i pare)**

Me 10 Maj 2009, Ortaku i Vetem i shoqerise tregtare "RIEN" sh.p.k, e perfaqesuar nga Administratorja znj. Floresha ISMAILAJ, ka vendosur per prishjen e shoqerise"RIEN" sh.p.k. Vendimi i mesiperm eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit me date 26 Shtator 2008 dhe ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese. Po ne kete vendim eshte emeruar likujdatori, z. Hetem SULAJ, me adrese, Rr. "Emin Duraku", pall. "Binjaket", kat.5/2, prane Stadiumit Dinamo ,Tiranë, i cili ka te drejtat dhe detyrimet e percaktuara ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqeritë tregtare".

Te dhenat e shoqeriae qe likujdohet "RIEN" sh.p.k.

E themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqipërisë si shoqeri me përgjegjësi të kufizuar dhe e rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit(QKR) (Ne gjykatën e shkalles se pare , Tirane me nr.vendimi 30580 date 20.11.2003)ne datë 26.09.2008.

Kapitali themeltar i saj eshte 100.000 leke, i ndarë në 100 kuota kapitali me vlere nominale 1.000 leke një kuote kapitali dhe zoterohet nga Ortaku i Vetem dhe Administrator i shoqerise , znj. Floresha Ismailaj ,rezidente ne Shqiperi. Selia zyrtare e shoqerise eshte:Rruga "Brigada e VIII-te", Pall. 8.shk. 2 apart.1, Tirane,Shqiperi.

Ftesa per kteditoret e shoqerise

Bazuar ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqeritë tregtare", neni 195, likujdatori i shoqerise ftohen kreditorët e saj për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Pretendimet tuaja duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të dytë te publikuar në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ne zyren e likujdatorit me adrese: Rr. "Emin Duraku", pall. "Binjaket", kat.5/2, prane Stadiumit Dinamo ,Tiranë dhe numra kontakti, tel/fax (04) 251 744 dhe cel. 069 20 42 251 , posta elektronike email , hsulaj@yahoo.com

LIKUJDATORI I "RIEN" sh.p.k (në likujdim)

Hetem SULAJ

